

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Kaçanikut z. Xhabir Zharku**

I nderuari z. Zharku,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Katërfishimin e investimeve gjatë katër viteve të ardhshme;
- Realizimin e 41projekteve të mëdha dhe të mesme;
- Mbrojtjen e mjedisit;
- Rritjen e nivelit të pastërtisë dhe inkasimin e rregullt;
- Vazhdimin e investimeve në infrastrukturën bazike;
- Shëndetësi bashkëkohore;
- Ndërtimin e spitalit të tuberkulozit;
- Subvencionimin e bujqësisë;
- Zhvillimin e turizmit;
- Ndërtimin e një shtëpie të kulturës, rrjetin e ujësjellësit për tërë fshatrat dhe rrjetin e kanalizimit për disa lagje në fshatit Gllloboçicë;
- Ndërtimin e një shkolle të re fillore në qytet;
- Shpërndarjen e fondeve për pemëtari;
- Uljen e papunësisë;
- Kthimin e kompanive regjionale në kompetenca të komunës;
- Ndarjen e një buxheti prej 40 mijë euro për sport;
- Ndërtimin e një palestere sportive;
- Ndërtimin e një stadiumi të mirëfilltë të futbollit në qytet;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)